



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:226057

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05437331

CN.2023:226058

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike jokontestimore të propozuesit G.Sh.S.nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av. Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj ndaj kundërpropozuesve E.J.Xh. nga Ferizaj, rr. ... nr. .. dhe B.M. nga Ferizaj, rr. ... nr. ..., me bazë juridike rregullim mexhe, pas mbajtjes së seancës përgatitore më dt. 26.02.2024, me datë 12.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike jokontestimore ndërpritet për shkak të vdekjes së kundërpropozuesit E.J.Xh.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-kundërpropozuesit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Propozuesi pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim më dt. 24.10.2023 ndaj kundërpropozuesve, me bazë juridike rregullim mexhe.

Pas mbajtjes së seancës përgatitore të dt. 26.02.2024 lidhur me këtë çështje, nga e autorizuar e propozuesit av. Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj më dt. 05.03.2024 në gjykatë kishte mbërritur parashtrësë me propozim për ndërprerje të procedurës, me arsyetimin se pas kontaktimit të propozuesit nga i njëjti është informuar se kundërpropozuesi E.J.Xh. ka vdekur ndërsa trashëgimtarët e tij janë jashtë vendit-Kosovës dhe deri në muajin korrik apo gusht nuk mund të mësoj emrat e tyre dhe adresat për vendbanimin e tyre. Andaj e autorizuar e propozuesit i

propozon Gjykatës që në këtë çështje jo kontestimore të ndërprejë procedurën për shkak të vdekjes së kundërpropozuesit E.Xh. nga Ferizaj, në kuptim të nenit 277.(a) të LPK e cila dispozitë përshtatshëmrisht aplikohet edhe në këtë procedurë sipas nenit 30 të LPJK.

Gjykata iu është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile-Ofiqarisë në Ferizaj me kërkesë për verifikim të faktit të vdekjes së kundërpropozuesit, ku për të njëjtin me datë 08.03.2024 ZGJC në Ferizaj, e ka njoftur gjykatën përmes adresës elektronike se i njëjti ka vdekur dhe si provë ia ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes së tij të datës 08.03.2024, me nr. rendor 74, nr. të referencës .../Sp, përmes së cilës vërtetohet se kundërpropozuesi E.Xh. ka vdekur me datën 01.10.2022 në R.

Andaj, bazuar në certifikatën e vdekjes dhe vetë faktit se tani kundërpropozuesi është i vdekur, konform dispozitave ligjore nga neni 277, pika a) të LPK-së lidhur me nenin 30 të LPJK, gjykata ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike jokontestimore. Ndërsa në kuptim të nenit 280.1 të LPK ka vendosur se procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-kundërpropozuesit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Nga arsyet e lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142 lidhur me nenin 387, pika e) të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 12.03.2024

Gjyqtari,
Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.